



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE

**RELACION**

**PËR PËRJASHTIMIN E PËRKOHSHËM TË TARIFAVE PËR DISA  
SUBJEKTE AKTIVITETI I TË CILËVE PREKET NGA INVESTIMET NË  
TERRITORIN E BASHKISË BERAT**

**Të nderuar këshilltar !**

Këshilli Bashkiak me Vendimin nr.60 datë 18.12.2019 ka miratuar paketën fiskale në të cilën janë përcaktuar taksat dhe tarifatat për subjektet që ushtojnë aktivitet tregtar në Bashkinë Berat.

Në territorin e Bashkisë Berat janë duke u implementuar disa projekte të rëndësishme për interesin publik.

Këto investime pavarësisht nga burimet e financimit dhe impaktit pozitiv që do të kenë në përfundim të tyre, gjatë implementimit, prekin zhvillimin normal të aktivitetit të biznesit, për faktin se janë investime që po zhvillohen rreth territorit të tyre ose kufizojnë në mënyrë të ndjeshme hapësirën për rreth.

Për arsyet e sipër përmendura vihet re qartë se ka një ndikim negativ në realizimin e të ardhurave të këtyre bizneseve.

Në kushtet ky risk vjen nga faktorë jo të biznesit, gjykojmë se, për periudhën e investimit për vitin 2021 të përjashtohen nga tarifatat vendore këto subjekte që kanë rënie të aktivitetit që zhvillojnë.

Jemi përpara faktit që po implementohet investimi në pedonale për parkimin nëntokësor, konkretisht nga ky investim preken tre subjekte. Subjektet konkrete janë të evidentura nga ana jonë dhe efekti financiar i tarifave vendore për këto subjekte për gjithë periudhën e investimit është në vlerën 116,300 lekë.

Për sa më sipër i propozojmë Këshillit Bashkiak me qëllim ardhjen në ndihmë të bizneseve që ushtrojnë aktivitet në këto zona:



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE

1. Përrjashtimin e përrkohëshëm të tarifave për tre subjektet që preken nga investimimi i parkimit nëntokësor në Bashkinë Berat për vitin 2021.

Efekti financiar për përrjashtimin nga tarifavat vendore për këto tre subjekte është në vlerën 116,300 lekë.

DREJTORI I TAKSAVE DHE I TARIFAVE

Sokol Toska